REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2022)

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}", i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***

10. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Maela Alicanaj, Marinela Osmani, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}", i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e datës 6 dhjetor të 2022.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës janë përfshirë sot 15 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit.

Nëse jeni dakord me rendin e ditës, pa humbur kohë kalojmë në çështjen e parë e cila ka të bëjë me caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z.{...}, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Ridvan Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Me shkresën e datës 23.11.2022 (depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor më datë 24.11.2022, me numër protokolli 5135/4) nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrën gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, kërkesë e cila bazohet në nenet 194 të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe nenin 138 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të bëra me vendimet sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me vendimet e dhëna nga magjistrati {...} nr. 63, datë 01.11.2017, nr. 112, datë 21.12.2017, nr. 60, 17.04.2022 dhe nr. 84, datë 10.02.2022, në të cilat janë ndërmarrë veprime/mosveprime që kanë të bëjnë me sjelljen e magjistratit që ka sjellë përfitime të padrejta ose dëme për palët në procesin gjyqësor në kundërshtim me ligjin, shkelje këto sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të parashikuara nga nenet 140, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 101, pika 1, shkronja "b", neni 102, pika 1 shkronja "dh", neni 102, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin".

Ka rezultuar se pas hedhjes së shortit, me vendimin 518, datë 01.12.2022 jam caktuar si relator i kësaj çështjeje. Jeni njohur me faktet dhe rrethanat e pretenduara (i keni në relacion). Kam bërë verifikimin paraprak lidhur me procedurën, sipas nenit 31 të Rregullores "Për procedurën disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor", nëse kemi ndonjë nga rastet e parashikuara nga neni 139 i ligjit "Për statusin" që bën që vendimmarrja e Këshillit të jetë me mbylljen e procedimit disiplinor. Nuk jemi para asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 139 dhe dispozitat e tjera: nuk është parashkruar sipas kërkesave të nenit 117, pra shkeljet janë brenda afatit 5-vjeçar; janë dy procedime disiplinore që kanë filluar në 27 shtator të 2017-ës dhe tjetri është brenda afatit (është i vitit 2022) dhe të cilat janë bashkuar pasi kemi të bëjmë me shkelje të bëra nga i njëjti magjistrat; gjithashtu, nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi tjetër disiplinor që të jetë përfunduar me vendim të formës së prerë; nuk ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin disiplinor sipas atyre të parashikuara në nenin 134/1/, shkronjat "ç" dhe "d" të ligjit "Për statusin", pra e ka statusin e magjistratit; shyqyr Zotit është gjallë; nuk është shkarkuar nga ndonjë procedim tjetër disiplinor; gjithashtu raporti i procedimit disiplinor është plotësisht në përputhje

me nenin 133, dhe nuk është nga ato që parashikon paragrafi 3 i nenit 133, pra që të jetë i paarsyetuar – është depozituar i arsyetuar dhe plotëson të gjithë elementët formalë.

Në mbledhjen e datës 02.12.2022, nga Komisioni Disiplinor, pasi u dëgjua nga relatori relacioni, u vendos kalimi i çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar dhe vendosur për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore për caktimin e datës dhe të orës, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...} ose mbylljen e procedimit disiplinor pa caktuar seancë dëgjimore.

Për sa më sipër, unë si relator, i propozoj mbledhjes plenare, meqenëse s'jemi në asnjë nga ato kushtet e parashikuara më sipër, kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë dëgjimore, e cila do zhvillohet brenda afatit 1-mujor dhe duhet mbajtur parasysh edhe njoftimi 15-ditor për palët, sipas parashikimeve të nenit 138 të ligjit.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ndonjë propozim për caktim date?

Ridvan Hado: Unë mendoj që data më e përshtatshme është data 22, ora 10:00. (Ripërsëritet) – 22 dhjetor, ora 10:00.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votim, bashkë me propozimin e kolegut, nëse nuk ka ndonjë propozim tjetër. Nëse jo, kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Caktimin e datës 22 dhjetor, ora 10:00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit, z. {...}, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2022)

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***

10. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt–aktin e dytë, i cili ka të bëjë me fillimin e procedurave të përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Të nderuar kolegë!

Paraqesim projektvendimin e radhës me objekt "fillimin e procedurave të përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022".

Me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 178, datë 11.05.2022 është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale. Brenda afatit ligjor të përcaktuar në atë vendim kanë kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale disa kandidatë nga radhët e gjyqtarëve, konkretisht: znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Për kandidatët, menjëherë pas përfundimit të afateve përkatëse të kandidimit, me vendimin nr. 220, datë 20.06.2022, "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë të shpallur, Këshilli filloi procedurat e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit.

Mbas përfundimit të procedurave të verifikimit, deri më sot, Këshilli ka vendosur kualifikimin e 4 kandidatëve, konkretisht: znj. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Propozimi i Komisionit – Referuar kësaj gjendjeje fakti, rezulton që në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë të kenë kandiduar kandidatë të kualifikuar për emërim (katër deri në momentin që ne sot po prezantojmë projektvendimin e radhës).

Ndodhur në këto kushte, referuar vendimit nr. 70, datë 07.02.2020, "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve", Kreun V ("Rregulla të përgjithshme të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë"), Seksioni A, pika 24, parashikon se: "Këshilli, jo më vonë së 7 ditë nga vendimi i parë për kualifikimin e një kandidati, vendos fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe cakton, nëpërmjet shortit, relatorin për atë procedurë. Për arsye të motivuara, mbi kërkesën e çdo anëtari të Komisionit, Këshilli mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti".

Në pikën 7, shkronja "j", përcaktohet se: "Procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë", nënkupton procesin administrativ të renditjes dhe përzgjedhjes, sipas rastit, kandidatin ose kandidatët e renditur më lart".

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin pasi rezulton që janë të gjitha rrethanat e faktit dhe kushtet ligjore për të paraqitur këtë projektvendim për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për emërimin në Gjykatën e

Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, për 1 (një) pozicion të lirë të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022.

Sipas këtij projektvendimi Këshilli duhet të përcaktojë relatorin për këtë procedurë përzgjedhjeje për emërim.

Lidhur me këtë, sipas projektvendimit, Komisioni ka vlerësuar që në rrethanat kur është edhe një pozicion i lirë në fushën e së drejtës penale, bazuar në vendimin e Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, ai duhet të zgjidhet me short ndërmjet 3 (tre) anëtarëve të përhershëm të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Pra është një vend i lirë, dhe të zgjidhet një ndërmjet të treve.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme ku në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale.

Struktura e vendimit është e parashikuar dhe të gjithë kolegët e kanë përpara.

Nëse do duhet ta lexoj edhe strukturën e vendimit.

Faleminderit!

Procedura e shortit si vijon:

Futen në vazon e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve (anëtarë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës): z. Klodian Kurushi, z. Alban Toro dhe z. Dritan Hallunaj.

Procedura e përzgjedhjes:

Për 1 (një) pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, relator përzgjidhet z. Klodian Kurushi.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votim, bashkë me propozimin e kolegut, nëse nuk ka ndonjë propozim tjetër. Nëse jo, kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, për 1 (një) pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për këtë procedurë përzgjedhjeje për emërim në fushën e së drejtës penale, si më poshtë:

a) Për 1 (një) pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale, relator z. Klodian Kurushi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2022)

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***

8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt–aktin tjetër i cili ka të bëjë me fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Në vijim edhe të asaj çka u relatua nga zoti Kurushi, për të mos rënë në përsëritje, bëhet fjalë për të njëjtin pozicion, për pozicionin e shpallur në Gjykatën e Lartë, në fushën e së drejtës penale, me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022. Për këtë pozicion kanë aplikuar 8 kandidatë. Për të 8 kandidatët janë verifikuar tre kushtet ligjore të kandidimit që kanë të bëjnë me përvojën profesionale minimale, mospasjen e masës disiplinore në fuqi dhe mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale. Në këto kushte, në zbatim të akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli, (rregullorja për ngritjen në detyrë dhe skema e vlerësimit të gjyqtarëve), Këshilli duhet të fillojë procedurën e vlerësimit të përshpejtuar për vitin e fundit kalendarik i cili përkon me vitin 2021.

Lidhur me vendimet e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit, ato janë të cituara në relacion, u cituan edhe nga zoti Kurushi.

Lidhur me bazën ligjore mbi të cilën është hartuar akti, në relacion referohet neni 97 i ligjit, i cili parashikon institutin e vlerësimit të përshpejtuar, neni 25 i ligjit 48 të vitit 2019 i cili i ka dhënë të drejtë këshillave që të miratojnë rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve gjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar, si dhe vendimi 263, datë 21.11.2019 i Këshillit, ku në nenin 22 është parashikuar se, sa herë që kërkohet ngritja në detyrë ose lëvizja paralele, Këshilli bën vlerësim të përshpejtuar të detyruar të gjyqtarit. Për këtë vlerësim zbatohen rregullat e përcaktuara për vlerësimin e përshpejtuar me kërkesë, me afate të përgjysmuara nga ato të parashikuara nga neni 18 i këtij vendimi.

Siç edhe relatova në fakt janë 8 kandidatë që kanë aplikuar për këtë pozicion, por për dy nga këta kandidatë, aktualisht ka dy vlerësime etike dhe profesionale, në kuptim të rregullores për ngritjen në detyrë, konkretisht: për gjyqtaren znj. {...} e cila ka kandiduar më herët për ngritje në detyrë në gjykatën e apelit, rezulton se Këshilli me vendimin nr. 542, datë 23.11.2021 ka miratuar raportin e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të gjyqtares për periudhën e vlerësimit viti kalendarik 2019. Njëkohësisht gjyqtarja është graduar edhe më parë për vitet 2013 – 2016. Në momentin e rikandidimit të gjyqtares në Gjykatën e Lartë (maj 2022), nuk kishin kaluar më shumë se 2 vjet nga vlerësimi i fundit, afat i cili në kuptim të nenit 97 të Ligjit për Statusin dhe nenit 22 të vendimit nr. 263, përbën kusht për fillimin përsëri të një vlerësimi të përshpejtuar. Në këto kushte

Komisioni vlerësoi se për këtë gjyqtare, kishte 2 (dy) vlerësime të mëparshme të realizuara tashmë nga Këshilli dhe në përputhje me nenin 48 pika 9 të Ligjit "Për statusin" dhe me pikën 78 të vendimit nr. 70, datë 07.02.2020 " Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë", nuk është e nevojshme që të fillojmë një vlerësim të ri të gjyqtares; po kështu, edhe për gjyqtaren {...}, e cila ka kandiduar më herët edhe për 2 (dy) pozicione të tjera në Gjykatën e Lartë, rezulton se Këshilli me vendimin nr. 177, datë 29.04.2021 ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017–2019, vlerësim i cili në kuptim të rregullores për ngritjen në detyrë do të përbëjë vlerësimin e dytë të gjyqtares për efekt të renditjes të saj edhe për këtë pozicion në Gjykatën e Lartë. Ndërkohë që për këtë gjyqtare vijon procedura e gradimit për periudhën 2013–2016, vlerësim i cili përbën vlerësimin e parë për efekt të renditjes së kandidatëve në pozicion.

Referuar kuadrit ligjor të mësipërm, Komisioni i propozon mbledhjes plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar për 6 (gjashtë) gjyqtarët e tjerë nga 8 (tetë) gjyqtarët që kanë plotësuar tre kriteret ligjore të kandidimit për Gjykatën e Lartë dhe konkretisht për gjyqtarët: {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}, për të cilët veç gradimit është e nevojshme të realizohet vlerësimi i 2–të i përshpejtuar, që përkon me vitin e fundit kalendarik (me periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021).

Lidhur me hartimin e projektvendimit – Në pikën e parë të projektvendimit është parashikuar ajo çka unë relatova, pra fillimi i procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për gjashtë gjyqtarët që kanë aplikuar për pozicionin e shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022.

Në pikën e dytë të projektvendimit është përcaktuar caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit, midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për relatorin, dhe ndërmjet dy nëpunësve të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, sipas nenit 12, pika 2 të vendimit nr. 263.

Në procedurën e shortit që do të zhvillohet për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar, Komisioni ka vlerësuar që të përfshihen të tre anëtarët e këtij Komisioni, duke

siguruar një shpërndarje të barabartë mes tyre (dy vlerësime për secilin anëtar). Ndërsa lidhur me numrin e nëpunësve përgjegjës që do të angazhohen në këtë vlerësimin, propozohet të përfshihen në short nëpunësit përgjegjës për vlerësimin znj. {...} dhe znj. {...}, duke siguruar një shpërndarje të barabartë mes tyre (tre vlerësime për secilin nëpunës).

Së fundi, në projektvendim parashikohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, ftoj administratën të bëjë gati hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në vazon e parë të qelqit shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Futen në vazon e dytë të qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve (anëtarë të Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional: znj. Brikena Ukperaj (2 shirita letre); znj. Irena Plaku (2 shirita letre); znj. Yllka Rupa (2 shirita letre).

Futen në vazon e tretë të qelqit shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin: znj. Esmerilda Habili (3 shirita letre) dhe znj. Gilda Hoxha (3 shirita letre).

Procedura e përzgjedhjes nga shorti:

Gjyqtari i parë i përzgjedhur është z. {...}. Relatore për zotin {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa. Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Gjyqtari i dytë i përzgjedhur është z. {...}. Relatore për zotin {...} përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj. Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Gjyqtari i tretë i përzgjedhur është z. {...}. Relatore për zotin {...} përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj. Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Gjyqtari i katërt i përzgjedhur është z. {...}. Relatore për zotin {...}përzgjidhet znj. Irena Plaku. Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Gjyqtari i pestë i përzgjedhur është znj. {...}. Relatore për zonjën {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku. Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Gjyqtari i gjashtë i mbetur në enën e qelqit është z. {...}. Relatore për zotin {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa. Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim projekt–aktin së bashku me shortin e kryer nga administrata.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha *(lapsus gjatë leximit, pasi sipas shortit rezultoi e përzgjedhur znj. Esmerilda Habili).*

Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj, Esmerilda Habili.

Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Edhe një herë përsërisim, për gjyqtarin {...}, relatore është znj. Irena Plaku dhe nëpunëse përgjegjëse znj. Esmerilda Habili.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2022)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për një shtesë në vendimin nr. 213, datë 16.06.2022 "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2022 – 2023", të Këshillit të Lartë Gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***

8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për një shtesë në vendimin nr. 213, datë 16.06.2022 "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2022 – 2023", të Këshillit të Lartë Gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt–akti i radhës, i cili ka të bëjë me hedhjen e shortit edhe në këtë rast, për një ndryshim "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2022 – 2023", të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, fjalën ia jap znj. Fatmira Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit!

Me cilësinë e relatores parashtroj përpara mbledhjes plenare nevojën për ndryshimin e vendimit nr. 213, datë 16.06.2022 "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2022 – 2023", të Këshillit të Lartë Gjyqësor" për të mundësuar caktimin e relatorit në mbledhjen plenare, nëpërmjet hedhjes së shortit për kandidaten {...}, për të cilën duhet të fillojë procedura e verifikimit, konkretisht si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja "d", të Kushtetutës është organi përgjegjës jo vetëm për përcaktimin e numrit të ndihmësve dhe këshilltarëve ligjorë por dhe verifikimin e kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit, ashtu dhe emërimin e tyre si nëpunës civil gjyqësor.

Në zbatim të këtyre detyrimeve Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 41, datë 31.01.2022, ka përcaktuar numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022 – 2023, ku ka përcaktuar në pikën 1, shkronja "b" edhe numrin e ndihmësve ligjorë që do të pranohen në formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës pas përfundimit me sukses të provimit të pranimit, në masën 10 kandidatë.

Ndërkohë, me vendimin nr. 125, datë 04.04.2022, "Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022 – 2023, për ndihmës ligjorë" Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e pranimit për formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, në total 3 kandidatë për ndihmës ligjorë.

Në zbatim të Kreut VI, Seksioni A, pika 61 - 62 të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020, "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose ndihmës ligjor", është vendosur që Këshilli të caktojë relatorin përkatës për znj. {...} me vendimin nr. 213, datë 16.06.2021 "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, viti akademik 2022 – 2023", Këshilli ka filluar procedurën e verifikimit të

kandidatëve për ndihmësit ligjorë, duke caktuar edhe relatorët përkatës për tre kandidatët e parë.

Nga ana tjetër, me vendimin nr. 264, datë 15.07.2022, "Për një shtesë në vendimin nr. 125, datë 04.04.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor", Këshilli, pasi ka konstatuar që disa kandidatë plotësojnë kriteret ligjore, ka vendosur që në Lidhjen 1, të pikës 1, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 125, datë 15.07.2021, të shtohen edhe 4 kandidatë të tjerë, ndër këta edhe znj. {...}. Ky vendim i është njoftuar Shkollës së Magjistraturës me shkresën nr. {...} prot., datë 18.07.2022.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. {...} prot., datë 12.10.2022 njoftuar se Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 32, datë 27.09.2022 miratoi znj. {...} me rezultatet përfundimtare të shpallura nga Komisioni i Vlerësimit të Shëndetit Mendor dhe Psikologjik të provimit të pranimit për vitin akademik 2022 – 2023. Bashkëlidhur kësaj shkrese, Shkolla ka dërguar edhe tabelën përkatëse.

Kurse me shkresën nr. {...} prot., datë 12.10.2022 Shkolla e Magjistraturës ka njoftuar se kandidatët e tjerë (z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}) kanë paraqitur kërkesë për heqje dorë për vijimin e studimeve për profilin e ndihmësit ligjor. Për këto persona nuk ka filluar verifikimi në Këshill, sepse kanë hequr dorë pa sjellë dokumentacionin dhe plotësuar deklarimet në Këshill.

Për këto arsye, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ka propozuar miratimin e projektvendimit "Për një shtesë në vendimin nr. 213, datë 16.06.2022 "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2022 – 2023", të Këshillit të Lartë Gjyqësor", për të mundësuar caktimin e relatorit nëpërmjet hedhjes së shortit për kandidaten {...}, për të cilën fillon procedura e verifikimit sipas pikës 1, të projektvendimit. Për sa i përket procedurës së shortit, propozojmë të ndiqen të njëjtat rregulla të ndjekura më përpara.

Struktura e projektvendimit është:

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se pas nënndarjes 3, të pikës 2, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 213, datë 16.06.2022, "Për fillimin e

procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2022 – 2023", shtohet nënndarja 4, si më poshtë:

4. Për znj. {...} - relator do të jetë personi që përzgjidhet në short.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet detyrimi i njoftimit të vendimit kandidates {...}, sipas pikës 64, të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në fund parashikohet hyrja në fuqi në mënyrë të menjëhershme dhe që botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, hedhim shortin.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në vazon e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve (anëtarë të Komisionit të Buxhetit): znj. Fatmira Luli dhe znj. Marçela Shehu.

Naureda Llagami: Në fakt, nga ana e Komisionit kemi një propozim, nëse pranohet nga Këshilli. Duke marrë parasysh ngarkesën që ka zonja Marçela Shehu, jo vetëm që është përfshirë në shortin e kandidatëve (në verifikim), por edhe në grupin e punës të hartës gjyqësore, atëherë ne si Komision vijmë me propozimin që relator të jetë zonja Fatmira Luli, në kushtet që unë në cilësinë e kryetares nuk mund të marr në shqyrtim akte individuale. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimin.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pas nënndarjes 3, të pikës 2, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 213, datë 16.06.2022, "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2022 – 2023", shtohet nënndarja 4, si më poshtë:

4. Për znj. {...} - relatore zonja Fatmira Luli.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kandidates znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2022)

***Pika 5 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli).[1]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***

[1] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e teta në rendin e ditës.

9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli).

Fillimisht citohet titulli i projekt–aktit i cili është pjesë e akteve që do shqyrtohen nga ana e Këshillit me dyer të mbyllura.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt–akti që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Relatore do të jetë zonja Fatmira Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit!

Me cilësinë e relatores parashtroj përpara mbledhjes relacionin mbi gjendjen e faktit dhe ligjit të zbatueshëm ku përfshihet edhe përmbledhja e të gjitha veprimeve të kryera nga Komisioni për kandidaten fituese për ndihmëse ligjore në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar, viti akademik 2022 – 2023, të zonjës {...}.

Znj. {...} është kandidate për në programin e formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili ndihmës ligjor dhe është vlerësuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të vendimit nr. 125, datë 04.04.2022, se i plotëson kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022 – 2023, profili "ndihmës ligjor", sipas nenit 34, pika 6, nenit 53, pika 4, dhe nenit 55, të ligjit nr.98/2016, si dhe në kreun V, të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020, të Këshillit.

Kandidatja ka marrë pjesë në provimin e organizuar dhe është përfshirë nga Shkolla e Magjistraturës, në listën e renditjes së kandidatëve fitues në programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor, viti akademik 2022 – 2023.

Në funksion të verifikimit në kohë të pasurisë dhe figurës, duke qenë se kjo procedurë është e ndërvarur nga raportimet dhe informacionet e subjekteve publike dhe private që, sipas ligjit, duhet t'i dërgohen Këshillit, sipas vendimit nr. 213, datë 16.06.2022, u vendos fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2022 – 2023, duke caktuar edhe relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat. Për ndihmësen ligjore znj. {...}, u caktua relatore znj. Fatmira Luli.

Në datën 16.06.2022, në respektim të detyrimeve të Seksionit A, Kreu VI, të vendimit 424/2020, znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës;
- për caktimin e relatores në këtë procedurë;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatores dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

Brenda afatit ajo depozitoi rregullisht formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit dhe nuk parashtroi asnjë ankesë lidhur me relatorin ose anëtar tjetër të Këshillit.

Në datën 20.06.2022, bazuar në pikat 65 dhe 66, kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse që duhet të plotësoheshin në kuadrin e verifikimit të kësaj procedure.

Në datë 29.06.2022, u njoftua Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit për listën e kandidatëve për në programin e formimit fillestar, për të cilët do të kryhej deklarimi i pasurisë dhe brenda këtij afati treditor kandidatja depozitoi formularët përkatës dhe autorizimet përkatëse për ILDKPKI–në.

Gjatë procedurës së verifikimit, nga data 16.06.2022, bazuar në pikën 67/b, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit 424/2020, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës.

Institucionet kompetente për verifikimin, i kanë përcjellë Këshillit të Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet në kohë të ndryshme.

Ndërkohë që nga ana e relatores po kryheshin procedurat e verifikimit, me shkresën nr.{...} prot., Shkolla e Magjistraturës ka informuar Këshillin se znj. {...}, me kërkesën e saj, të depozituar me nr. {...} prot., datë 28.09.2022, i është drejtuar Shkollës së Magjistraturës për heqjen dorë nga e drejta për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar, duke dhënë edhe shkakun e kësaj dorëheqje për arsye se qëllimi i saj është të jetë pjesë e magjistratëve në profilin gjyqtar/prokuror.

Sipas pikës 1 të Kreut I, të vendimit 424/2020 parashikohet se qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, si dhe të pasurisë dhe të figurës së tij, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor. Në pikën 2, ky

vendim përcakton procedurat e verifikimit edhe për kandidatin fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për profilin "ndihmës ligjor".

Neni 29 i Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës parashikon : "2. Kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë dhe për pozicionet në Avokaturën e Shtetit të shpallur fitues nënshkruajnë marrëveshjen e regjistrimit, e cila parashikon të drejtat dhe përgjegjësitë e kandidatit përgjatë Programit të Formimit Fillestar. 3. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, kandidati për magjistrat, kandidati për ndihmës ligjor dhe për pozicionet në Avokaturën e Shtetit konsiderohet i regjistruar në Shkollën e Magjistraturës, në bazë të ligjit nr. 115/2016. [...] 5. Refuzimi për nënshkrimin e marrëveshjes së regjistrimit, sjell, si pasojë, heqjen nga lista të fituesit dhe humbjen e së drejtës për të filluar dhe ndjekur Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Në këtë rast, Këshilli Drejtues i Shkollës raporton pranë KLGJ–së, KLP–së dhe Avokaturës së Shtetit, sipas rastit mbi situatën e krijuar…."

Neni 95, i të Kodit të Procedurave Administrative parashikon: "Pamundësia në objekt apo qëllim". Sipas këtij neni: "Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur."

Nga interpretimi i dispozitave ligjore, si më lart, del e qartë se organi publik, i cili zhvillon procedurën, detyrohet të deklarojë përfundimin e saj, në rastin kur konstaton ekzistencën e njërit prej rasteve të parashikuara nga neni 95, i Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë dispozitë përmenden terma ligjorë të përgjithshëm dhe të papërcaktuar siç janë "Pamundësia", "objekti" dhe "qëllimi", por, të cilat, duke u aplikuar në raste konkrete, qartësojnë dhe përcaktojnë vendimmarrjen e organit publik në lidhje me vazhdimësinë e procedurave, të filluara kryesisht nga ana e tij. Nga ana tjetër, duket i qartë interpretimi se qëllimi i procedurës bëhet i pamundur, në rastin kur kryerja e një veprimi administrativ, ka humbur aktualitetin, për shkak të ndryshimit të rrethanave, të cilat mund të jenë faktike ose ligjore.

Me heqjen dorë nga znj. {...}, nga e drejta për të ndjekur programin e formimit fillestar, ka sjellë si pasojë rënien e shkakut për të cilin kjo procedurë ka filluar dhe për

këtë arsye, vlerësohet se qëllimi i saj nuk ekziston më. Znj. {...} nuk ka më statusin e kandidatit fitues, status për shkak të të cilit ka filluar nga ana e Këshillit procedura administrative e verifikimit të pasurisë dhe figurës. Për pasojë qëllimi i këtij procedimi është bërë i pamundur, çka passjell përfundimin e kësaj procedure pa vendim përfundimtar.

Deklarimi i përfunduar i procedurës, nuk zgjidh themelin e çështjes, fakt i cili nuk pengon fillimin kryesisht të procedurës apo me kërkesë të palës së interesuar, në kuadër të një procedure tjetër, me objekt dhe qëllim të përcaktuar në ligj.

Sa më lart, vlerësohet se procedura e vlerësimit ndaj znj. {...}, duhet të deklarohet e përfunduar, për arsye se znj. {...} nuk gëzon më statusin e kandidatit fitues, cilësi dhe arsye mbi bazën e së cilës ka filluar procedura administrative e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga ana e Këshillit.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten për ndihmëse ligjore, znj. {...}, relatorja, në përputhje me kërkesat vendimit që mori Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, ju parashtron (vendosi): Kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit, për znj. {...}.

Projektvendimi parashikon në pikën e parë: Deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të znj. {...}, të filluar me vendimin nr. 213, datë 16.06.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të humbjes të statusit të kandidates fituese për ndihmëse ligjore, në programin e formimit fillestar, viti akademik 2022 – 2023.

Një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016.

Pika 3: Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, në qoftë se nuk keni diskutime dhe debate, kalojmë në votimin e projekt–aktit, sipas propozimit të sjellë nga relatorja.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të znj. {...}, të filluar me vendimin nr. 213, datë 16.06.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të humbjes të statusit të kandidates fituese për ndihmëse ligjore, në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023.

2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2022)

***Pika 6 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***

10. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit "Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt–akti i radhës, i cili ka të bëjë me ndryshimin në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka përcaktuar gjykatat e shkallës së parë pranë të cilave kandidatët për gjyqtarë, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, do të kryejnë praktikën profesionale. Gjithashtu Këshilli ka

përditësuar trupën e gjyqtarëve magjistratë udhëheqës të cilët do të ndjekin mentorimin e kandidatëve për gjyqtarë.

Ndërkohë, vendimi i Këshillit për caktimin e gjyqtarëve udhëheqës ka pësuar disa ndryshime, konkretisht me vendimin:

i) nr. 357, datë 27.07.2022, është zëvendësuar gjyqtari udhëheqës z. {...} me gjyqtarin udhëheqës z. {...};

ii) nr. 370, datë 13.09.2022, është zëvendësuar gjyqtari udhëheqës z. {...} me gjyqtarët udhëheqës z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...} dhe;

iii) nr. 415, datë 10.10.2022, është zëvendësuar gjyqtari udhëheqës z. {...} me gjyqtarët udhëheqës znj. Vjollca Spahiu, dhe znj. {...}.

Rezulton se një nga gjyqtarët udhëheqës, pjesë e listës, e caktuar për mentorim në seksionin e dytë dhe të tretë 4–mujor znj. {...}, është shkarkuar me vendim të KPK–së, çka ka sjellë pezullimin e saj nga detyra e gjyqtarit.

Në këto kushte është detyrë e Këshillit që të bëjë zëvendësimin në mentorim të këtij magjistrati udhëheqës. Ky zëvendësim duhet të bëhet për të dy sesionet 4-mujore që i përkasin praktikës profesionale për muajt nëntor 2022 – shkurt 2023 dhe mars 2023 – qershor 2023, sigurisht për periudhën që ka mbetur nga sesioni i dytë katërmujor.

Në caktimin e gjyqtarëve pranë të cilëve do të kryejnë stazhin profesional kandidatët e caktuar me herët pranë gjyqtares {...}, Komisioni propozon zëvendësimin me gjyqtaren {...} në sesionin e dytë dhe gjyqtaren {...} në sesionin e tretë, duke konsideruar faktin se (i) të dy gjyqtarët janë pjesë e trupës së magjistratëve udhëheqës të miratuar me vendim të Këshillit (ii) ushtrojnë funksionin në seksionin civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe (iii) /nuk rezulton të jenë caktuar më herët nga Këshilli si gjyqtarë udhëheqës për ndonjë kandidat për magjistrat gjatë sesionit të dytë dhe të tretë vitit akademik 2022 – 2023.

Për këto arsye, Komisioni propozon se ka vend për zëvendësimin e gjyqtarit udhëheqës znj. {...} me:

(i) znj. {...}, gjyqtare në seksionin civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës do të mbikëqyrë praktikën profesionale të kandidatit për magjistrat z. {...}, në sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2022 – shkurt 2023) dhe;

(ii) gjyqtaren {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magjistrat {...}, për sesionin e tretë 4–mujor (mars 2023 – qershor 2023).

Në pikën e parë të projektvendimit, është parashikuar pikërisht ky ndryshim që unë relatova më sipër.

Në pikën e dytë është parashikuar njoftimi Shkollës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjyqtarëve respektivë: znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Së fundmi, parashikohet momenti i hyrjes në fuqi menjëherë dhe botimi i tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit znj. Brikena!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime nga kolegët, kalojmë në miratimin e projekt–aktit, sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022, gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, duke zëvendësuar gjyqtaren udhëheqëse znj. {...} me: (i) gjyqtarin udhëheqës znj. {...} në sesionin e dytë katër mujor nëntor 2022 – shkurt 2023 dhe (ii)

gjyqtarin udhëheqës znj. {...} në sesionin e tretë katër mujor mars 2023 – qershor 2023.

2. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjyqtarëve znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq kemi mbyllur çështjet të cilat janë publike.

Vijojmë sipas rendit me çështjet e tjera që zhvillohen me dyer të mbyllura.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor